



“Rivitalizimi i Shkolla Qendër Komunitare në Kurjan për një qasje më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e skajuar”

RAPORT

HARTËZIMI DHE VLERËSIMI I NEVOJAVE TË GRUPIT TË SYNUAR NË KRUJAN BASHKIA ROSKOVEC





Co-funded by
the European Union

Titulli i raportit:

Hartëzimi dhe vlerësimi i nevojave të grupit të synuar në Kurjan, Bashkia Roskovec

Publikues:

Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)

Autor:

Erida Curraj

Redaktor:

Blerjana Bino

Kontribuan në raport stafi i Bashkisë Roskovec:

Enirjeta Shehu, Qamil Kuka, Aleksander Sheme, Durim Bakaj, Qamil Xhoka, Behar Shytia

Tiranë, Maj 2023

©SCiDEV

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e SCiDEV dhe Bashkisë Roskovec dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.

“Rivitalizimi i Shkolla Qendër Komunitare në Kurjan për një qasje më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e skajuar”, është një projekt i zbatuar nga Bashkia Roskovec në partneritet me SCiDEV dhe bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.

Mesazhi i Kryetares, Znj. Majlinda Bufi



Vendosja e prioriteteve dhe plani i veprimit janë dy elementë që përmes këtij raporti realizohen duke mbledhur të dhënat dhe informacionin e duhur në identifikimin e nevojave dhe mundësitë reale për plotësimin e tyre.

Përfshirja e gjithë komunitetit në këtë proces ka një rëndësi të veçantë. Me këtë qasje, ne mund të kemi një ndikim pozitiv në problemin që dëshirojmë të

trajtojmë. Kuptimi i nevojave dhe asetëve të komunitetit do të na ndihmojë gjithashtu të qartësojmë se ku duam të shkojmë dhe se me çfarë instrumenta mund të arrijmë atje.

Kryerja e një vlerësimi të nevojave të komunitetit jo vetëm që na ndihmon të identifikojmë problemet dhe mangësitë e shërbimit në një komunitet, por gjithashtu vendos bazën thelbësore për përmirësimin e jetës së tyre.



Përmbledhje ekzekutive

Projekti "Rivitalizimi i Shkolla Qendër Komunitare në Kurjan për një qasje më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e skajuara", zbatohet nga Bashkia e Roskovecit në partneritet me SCiDEV dhe bashkëfinancuar nga Bashkimi European (BE). Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i zhvillimit social dhe ekonomik në bashkinë Roskovec nëpërmjet punësimit të qëndrueshëm dhe mundësive të gjenerimit të të ardhurave si alternativë ndaj kultivimit dhe trafikimit të kanabisit dhe shërbimeve të integruara publike në nivel vendor.

Qëllimi i këtij raporti është të bëjë një vlerësim të nevojave dhe sfidave aktuale në fushat e arsimit, punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave në Bashkinë Roskovec. Ky vlerësim përfshin jo vetëm identifikimin e nevojave specifike të grupit të synuar përmes një pyetësori në Kurjan dhe në Roskovec, por edhe një analizë të situatës aktuale të shërbimeve të ofruara nga bashkia në këto fusha.

Metodat e vlerësimit të nevojave në kuadër të këtij projekti kanë përfshirë përdorimin e një pyetësori online, i cili është plotësuar nga 106 qytetar me asistencën e stafit mbështetës të projektit dhe stafi i Bashkisë në terren në zonat e Kurjanit dhe Roskovecit. Përveç kësaj, janë organizuar dy grupe fokusi me 11 punonjës të Bashkisë për të diskutuar mbi nevojat e tyre specifike në ofrimin e shërbimeve. Një pyetësor i shkurtër është përdorur gjithashtu për të vlerësuar Bashkinë në lidhje me situatën aktuale të shërbimeve dhe nevojat specifike të tyre.

Është e qartë që pavarësisht përpjekjeve shumë proaktive dhe vullnetit të qartë të Bashkisë dhe lidershit të saj për të përmirësuar shërbimet për arsimin, punësim dhe gjenerim të ardhurash, sërish sfidat janë të pranishme edhe për shkak të kontekstit të përgjithshëm social dhe ekonomik të zonës dhe Shqipërisë në tërësi.

Sugjerimet konkrete janë:

Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të bashkisë për projekte për ngritje fondesh për të ofruar më shumë mundësi për qytetarët si edhe zhvillimi i kapaciteteve të stafit të shërbimeve të bashkisë lidhur me ofrimin e shërbimeve të punësimit, ndërlidhjes me Zyrat e Punës dhe qendrat e formimit profesional si edhe bizneset lokale.



Bashkia Roskovec duhet të vazhdojë të jetë aktive në angazhimin me institucionet vendore dhe kombëtare, si dhe me donatorët dhe partnerët ndërkombëtar, për të siguruar mbështetje financiare dhe teknike në zhvillimin e projekteve të ardhshme. Kjo do të jetë e rëndësishme për të garantuar vazhdueshmërinë e përmirësimeve dhe për të adresuar sfidat e pranishme dhe të ardhshme.

Bashkia duhet të punojë në bashkëpunim me partnerët e saj në komunitet, duke përfshirë shkollat, universitetet, organizatat jofitimprurëse dhe bizneset lokale. Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar dhe të përqendruar mund të arrihet një ndryshim i madh në ofrimin e shërbimeve për nxënësit e 9-vjeçareve dhe gjimnazeve në Bashkinë Roskovec.

Rezultatet e këtij pyetësi tregojnë se ka nevojë për më shumë investime në trajnime dhe zhvillim profesional, si dhe në mbështetje financiare dhe logjistike për individë që dëshirojnë të punojnë në fushën e bujqësisë dhe fermërisë. Këto investime mund të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e punësimit dhe stimulimin e ekonomisë lokale në zonat e Krujës dhe Roskovecit.



Tabela e Përmbajtjes

Mesazhi i Kryetares, Znj. Majlinda Bufi

Përmbledhje ekzekutive

Tabela e Përmbajtjes

Lista e figurave

Shkurtime

I. HYRJE

1.1 Rreth Kurjan

1.2 Rreth projektit

1.3 Qëllimi i raportit

1.3 Metodat e vlerësimit të nevojave

1.4 Struktura e raportit

II. Nevojat e Bashkisë Roskovec për ofrimin e shërbimeve

III. Nevojat e komunitetit në Kurjan

IV. Përfundime

V. Rekomandime

VI. Aneksë

6.1 Guida e intervistës për punonjësit e bashkisë

6.2 Udhëzues për fokus grup me Bashkinë

6.3 Pyetëtori për qytetarët

6.4 Lista e pjesëmarrësve në fokus grupe

6.5 Fotografi nga aktivitetet për realizimin e vlerësimit të nevojave



Lista e figurave

Figura 1: Imazh nga Agjencia Telegrafike - Kurjan

Figura 2: Kampioni i pyetësorit

Figura 3: Statusi i punësimit

Figura 4: Nevojat për trajnime

Figura 5: Format e mbështetjes për biznese



Co-funded by
the European Union

Shkurtime

Bashkia

BE

SCiDEV

ZVA

Bashkia Roskovec

Bashkimi European

Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim

Zyra Vendore Arsimore

I. HYRJJE

Në këtë kapitull do të parashtrohet konteksti i projektit si edhe qëllimi dhe qasja ndaj vlerësimit të nevojave.

1.1 Rreth Kurjan



Njësia Administrative e Kurjanit është një entitet administrativ që gjendet në zonën e Kurjanit, Bashkia Roskovec. Kjo njësi përbën një komunitet të pasur dhe të gjallë me një popullsi prej 5,325 banorësh. Banorët e Kurjanit kontribuojnë në formimin e peisazhit kulturor të zonës. Në fushën e arsimit, njësia administrative ofron shërbime cilësore për fëmijët e saj.

Figura 1: Imazh nga Agjencia Telegrafike - Kurjan

Në Kurjan gjenden disa kopshte dhe shkolla të rëndësishme. Këto përfshijnë:

Kopshte:

- a. Kopshti në fshatin Mbers
- b. Kopshti në fshatin Vlosh
- c. Kopshti në fshatin Ngjeqar

Shkolla:

- a. Shkolla 9-Vjeçare "Jashar Muhameti", e vendosur në Vlosh
- b. "Sabri Refiti", e vendosur në Ngjeqar.

Shkolla e Mesme e Bashkuar:

- a. "Didin Bishani", një shkollë e mesme e bashkuar, ofron arsim të nivelit të mesëm për të rinjtë në Kurjan. Kjo shkollë përfshin një kopsht, një shkollë 9-vjeçare dhe një gjimnaz.

Ekonomia e njësisë administrative Kurjan është e përqendruar kryesisht në bujqësi. Kultivimi i ullirit është një nga aktivitetet kryesore bujqësore në zonë. Përveç kësaj, emigracioni ka ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Kurjanit.

1.2 Rreth projektit

Projekti "Rivitalizimi i Shkolla Qendër Komunitare në Kurjan për një qasje më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e skajuara", zbatohet nga Bashkia e Roskovecit në partneritet me SCiDEV dhe bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian (BE). Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i zhvillimit social dhe ekonomik në bashkinë Roskovec nëpërmjet punësimit të qëndrueshëm dhe mundësive të gjenerimit të të ardhurave si alternativë ndaj kultivimit dhe trafikimit të kanabisit dhe shërbimeve të integruara publike në nivel vendor.

Projekti ka dy objektiva kryesorë:

- Rritja e mundësive të punësimit dhe të ardhurave për të rinjtë e Kurjanit si një alternativë ndaj aktiviteteve të paligjshme nëpërmjet rivitalizimit të shkollës së mesme lokale si qendër komunitare dhe formimi profesional.
- Forcimi i kapaciteteve të Bashkisë Roskovec për të rritur ndërgjegjësimin e publikut kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, duke u fokusuar tek të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël nëpërmjet shërbimeve publike të integruara në arsim, trajnim profesional dhe gjenerim të ardhurash.

Projekti ofron një sërë përfitimesh dhe mundësish për komunitetin lokal si më poshtë:

Rinovimi i Infrastrukturës së Arsimit:

Projekti synon të ofrojë një shkollë të rikonstruktuar dhe të modernizuar, e pajisur me ambiente dhe pajisje për formimin profesional dhe trajnimin. Ai gjithashtu parasheh implementimin e programeve të trajnimit të personalizuara që u përgjigjen nevojave të komunitetit lokal, duke ofruar kurse trajnimi profesional për të rinjtë dhe grupe të skajuara. Gjithashtu, projekti do të ofrojë një program mentorimi dhe përsheptimi për të mbështetur sipërmarrjen në agroturizëm, produktet artizanale lokale dhe bizneset e vogla.

Fuqizimi i Bashkisë:

Përmes projektit, bashkia do të përfitojë nga një program i zhvillimit të kapaciteteve për stafin e saj, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve publike për t'u përshtatur më mirë me nevojat e komunitetit lokal. Gjithashtu, projekti synon të rrisë aksesin në shërbimet lokale për grupet vulnerabël, duke lehtësuar hyrjen në arsim dhe duke ndihmuar në praktikë dhe punësim.



Më tej, ai mbështet fushatat e ndërgjegjësimit të publikut dhe angazhimit të komunitetit për të luftuar kultivimin dhe trafikimin e kanabisit, në bashkëpunim me aktorë lokalë si shkollat, policia, shoqëria civile dhe media.

Synimi i projektit është të arrijë një sërë rezultatesh pozitive, duke përfshirë përmirësimin e shërbimeve në Bashkinë Roskovec, rritjen e mundësive të punësimit për të rinjtë, gratë dhe grupe të skajuara, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, dhe rritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë për të ngritur ndërgjegjësimin e publikut dhe për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse për grupet e skajuara.

1.2 Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është të bëjë një vlerësim të nevojave dhe sfidave aktuale në fushat e arsimit, punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave në Bashkinë Roskovec. Ky vlerësim përfshin jo vetëm identifikimin e nevojave specifike të grupit të synuar përmes një pyetësi në Kurjan dhe në Roskovec, por edhe një analizë të situatës aktuale të shërbimeve të ofruara nga bashkia në këto fusha. Nëpërmjet këtij raporti, synohet të hartohen dhe përshtaten ndërhyrjet e ardhshme të projektit si trajnimet dhe kualifikimet profesionale që do të ofrohen në shkollën qendër komunitare të rikonstruktuar si edhe grantet që do të jepen për start-ups. Kështu ky raport do të ndihmojë në përmirësimin e ofertës dhe efektivitetit të këtyre shërbimeve, duke përqendruar përpjekjet në plotësimin e nevojave për kualifikim, trajnim profesional, punësim dhe gjenerim të të ardhurave për komunitetin lokal.

1.3 Metodatat e vlerësimit të nevojave

Metodat e vlerësimit të nevojave në kuadër të këtij projekti kanë përfshirë përdorimin e një pyetësi online, i cili është plotësuar nga 106 qytetar me asistencën e stafit mbështetës[1] të projektit dhe stafi i Bashkisë në terren në zonat e Kurjanit dhe Roskovecit. Ky pyetësor ka ndihmuar në identifikimin e sfidave dhe nevojave aktuale të komunitetit në këto zona. Përveç kësaj, janë organizuar dy grupe fokusi me 11 punonjës të Bashkisë për të diskutuar mbi nevojat e tyre specifike në ofrimin e shërbimeve. Këto diskutime kanë ofruar informacione të vlefshme mbi sfidat me të cilat ata përballen në punën e tyre të përditshme dhe mbi mënyrat për të përmirësuar

[1] Intervistat u zhvilluan nga Qamil Kuka, Aleksander Sheme, Durim Bakaj, Qamil Xhoka, Behar Shytia

shërbimet për komunitetin. Një pyetësor i shkurtër është përdorur gjithashtu për të vlerësuar Bashkinë në lidhje me situatën aktuale të shërbimeve dhe nevojat specifike të tyre, duke siguruar një pasqyrë më të plotë të sfidave dhe prioriteteve për përmirësimin e shërbimeve në Bashkinë Roskovec.

Metodat e vlerësimit të nevojave të përdorura në këtë projekt janë përzgjedhur me kujdes për të siguruar informacion të detajuar dhe të saktë për të informuar vendimet e ardhshme të projektit. Përdorimi i një pyetësoi online ka lejuar një mbledhje të gjerë të të dhënave në mënyrë efikase dhe të strukturuar. Përveç kësaj, kjo metodë ka lejuar përfshirjen e një numri të madh të individëve, duke siguruar një perspektivë më të gjerë të nevojave dhe sfidave të komunitetit.

Grupet e fokusit me punonjësit e Bashkisë, nga ana tjetër, kanë ofruar një mundësi për diskutime më të thella dhe më të detajuara. Këto diskutime kanë lejuar identifikimin e çështjeve specifike dhe të komplikuar që mund të mos kapen në një pyetësor standard. Kjo metodë gjithashtu ka ndihmuar në krijimin e një lidhjeje më të fortë me punonjësit e Bashkisë, duke i përfshirë ata direkt në procesin e vlerësimit dhe duke ndërtuar një kuptim të përbashkët të sfidave dhe nevojave.

Pyetësori i shkurtër për Bashkinë ka ndihmuar për të identifikuar nevojat dhe sfidat specifike të Bashkisë, duke plotësuar informacionin e mbledhur nga pyetësori online dhe grupet e fokusit. Kjo metodë ka ofruar një pasqyrë më të qartë të nevojave dhe prioriteteve të Bashkisë, duke u lejuar kështu projektuesve të përqendrohen më drejtpërdrejt në ato çështje që janë më kritike për përmirësimin e shërbimeve.

Në përgjithësi, përdorimi i këtyre metodave ka ndihmuar në krijimin e një baze të të dhënave të pasura dhe të detajuara që do të informojë vendimet e ardhshme të projektit. Ky është një kërkim praktik që synon të sigurojë se vendimet dhe aktivitetet e projektit janë të bazuar në nevojat reale dhe aktuale të komunitetit dhe Bashkisë.

1.4 Struktura e raportit

Krahas hyrjes, raporti përban dy seksione kryesore të analizës së nevojave të bashkisë dhe të qytetarëve, një seksion me përfundimet që ccojnë më tej tek rekomandimet për fazat dhe aktivitetet e mëtejshme të projektit.

II. Nevojat e Bashkisë Roskovec për ofrimin e shërbimeve

Në këtë seksion paraqiten gjetjet e vlerësimit të situatës aktuale të shërbimeve të edukimit, punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave në Bashkinë Roskovec.

Gjatë fokus grupeve të mbajtur në Prill 2023, ku morën pjesë grupi i punës i projektit dhe ekspertë të Bashkisë në fushën e arsimit, bujqësisë dhe biznesit (11 pjesëmarrës), u diskutuan tri tematika kryesore: shërbimet e edukimit, shërbimet e punësimit dhe shërbimet e gjenerimit të të ardhurave.

Arsimi ishte një temë e ndjeshme për pjesëmarrësit. Është e qartë se rritja dhe edukimi i brezave të rinj dhe trajnimi i fuqisë punëtore janë çelës për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës së studiuar. Kjo do të kontribuojë jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, por do të shtojë edhe kërkesën për punë të cilësisë së lartë, duke tërhequr dhe mbajtur trurin në zonë, si dhe fuqinë blerëse.

Nga ana e ekspertëve të drejtorisë arsimore, u evidentuan përmirësimet e infrastrukturës si një aspekt pozitiv. Megjithatë, sfidat mbeten të pranishme, veçanërisht në rekrutimin e mësuesve të kualifikuar dhe në administrimin e arsimit. Një tjetër sfidë është në sigurimin e vazhdimësisë të përmirësimeve në kurrikula, mësimdhënie dhe kurse të vazhdueshme, të cilat janë të orientuara drejt nevojave të zonës.

Fokus grupi identifikoi disa çështje specifike:

1. Në fushën e arsimit, bashkia Roskovec operon 15 shkolla dhe 17 kopshte, si dhe 1 çerdhe. Megjithatë ka pasur përmirësime në shërbimet arsimore gjatë viteve të fundit, cilësia dhe përfshirja mbeten ende të kufizuara. Laboratorët për lëndët shkencore janë në mungesë apo janë minimaliste, i cili është një problem i madh.
2. Transporti është një çështje e rëndësishme. Ndërsa transporti për nxënësit e shkollave 9-vjeçare ofrohet nga drejtoria arsimore, ky shërbim nuk ofrohet për nxënësit e shkollave të mesme, duke pasur parasysh që arsimi i mesëm nuk është i detyrueshëm. Kjo i bën disa shkolla profesionale të ofrojnë transportin për të tërhequr nxënësit.
3. Kurse të ndryshme ofrohen në Qendrën Komunitare ZVA në Kurjan në fushën e sporteve, artit dhe bujqësisë. Përkundër interesit të lartë të nxënësve, transporti

për të arritur në këto kurse mund të jetë një pengesë për disa prej tyre.

4. Si në çdo zonë tjetër në Shqipëri, Roskoveci po përjeton një ulje të vazhdueshme të numrit të fëmijëve dhe të të rinjve për shkak të largimit të familjeve, uljes së lindjeve dhe tendencës së të rinjve për të studiuar jashtë dhe mos të kthehen. Kjo ka një ndikim negativ në numrin e të edukuarve, fuqinë punëtore dhe fuqinë blerëse në zonë.

Në kontekstin e të rinjve që zgjedhin të qëndrojnë në Roskovec pas shkollës së mesme, është e rëndësishme të theksojmë se një pjesë prej tyre angazhohen në bizneset familjare, ndërsa një segment tjetër përballen me papunësinë.

Sipas të dhënave të mbledhura nga Bashkia gjatë vitit shkollor 2022-2023, numri i nxënësve të regjistruar në arsimin parashkollor në bashkinë Roskovec është 452, në çerdhe 18, dhe në arsimin parauniversitar është 2480. Analiza e rrjedhës së studimeve tregon se rreth 80% e nxënësve vazhdojnë gjimnazin e përgjithshëm pas shkollës 9-vjeçare, dhe vetëm 10% e tyre zgjedhin gjimnazin profesional. Pas gjimnazit, vetëm rreth 15% e nxënësve regjistrohen në shkolla profesionale, ndërsa mbi 50% vazhdojnë studimet universitare.

Sa i përket nevojave të fëmijëve jashtë shkollës, është e rëndësishme që të përfshihen në aktivitete jashtëshkollore që kontribuojnë në rritjen dhe formimin e tyre. Aktivitetet e tilla janë të shumëllojshme dhe mund të përfshijnë sporte të ndryshme, aktivitete teatrale, kurse muzikore, arti, informatikë në përputhje me moshën e fëmijëve, gjuhë të huaja, dhe madje edhe kurse gatimi. Këto aktivitete jo vetëm që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive dhe interesave të tyre, por edhe kontribuojnë në formimin e tyre si individë dhe si qytetarë aktivë të komunitetit.

Bashkia Roskovec në mbështetje nga Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka qenë përfituese për projektin Agrotech (Agrikulturë Roskovec Teknologji), nga i cili kanë qenë përfitues 300 të rinj në trajnimet e zhvilluara nga trajnuesit e projektit. Nga ky projekt Bashkia Roskovec ka në gjendje një inkubator me pajisje teknologjike, 6 kompjutera dhe disa mini robot junior të cilët nuk i ka përdorur pas përfundimit të projektit pasi për vazhdimësinë e tij është i nevojshëm trajnimi në fushën e laboratorit gjë e cila nuk mund të sigurohet nga Bashkia pasi nuk e ka kapacitetin e duhur për të vazhduar këto trajnime.

Përsa i përket të rinjve në bashkinë Roskovec nuk ka ende një praktikë të mirëfilltë për rikthimin e tyre por theksojmë se numri me i lartë i punonjësve të punësuar pranë



Bashkisë Roskovec janë të rinj që i përkasin moshës 18-30 vjeçe, një pjesë e mirë e tyre janë dhe në pozicione të mesme në punë.

Bashkia Roskovec ka vështirësi në mbledhjen e informacioneve të nevojave konkrete dhe në kohë reale të bizneseve apo prodhuesve në zone. Bizneset dhe Prodhuesit nuk kanë një platformë ku të shpallin lajmërimet dhe ku të shpërndajnë nevoja që kanë për punonjës dhe kualifikimet e tyre. Bashkia Roskovec i merr të dhënat nga Zyra e Punës që është në Fier dhe për të diturpunëkërkuesit për Roskovecin duhet të merren të dhënat në këto zyra pune. E-Albania i ofron shërbim qytetarëve që të rregjistrohen si punëkërkues por këtu qëndron vështirësia e përdorimit të saj masivisht nga të gjithë qytetarët.

One-Stop-Shop ofron 11 Aplikacione në Bashkinë Roskovec ndër to edhe kërkesën për punësim. Bizneset për të promovuar dhe bërë lajmërimet përdorin leafletet ose dy stacionet kablore të zonës.

Praktika ka treguar që vetëm kompanitë e mëdhaja si prodhuesi i Ullirit dhe fasoneritë që duan numër të madh punonjësish i drejtohen për ndihmë bashkisë. Punësime që ofron Bashkia Roskovec janë të disa llojeve, ku ato të përhershmet kërkojnë kualifikime për të cilat nuk ka aplikues, ndërsa ka edhe punë sezonale (pastrim, gjelbërim) ose punë me kontratë si në rastin e këtij projekti, por këto janë sporadike dhe mbarojnë me mbylljen e projekteve.

Punëkërkuesit në Bashkinë Roskovec nuk kanë një zyrë e cila të merret me përpunimin e të dhënave për personat e regjistruar si të papunë ose numrin e personave të punësuar për zonën në fjalë, bashkia ka informacion vetëm për punëkërkuesit të cilët kanë dorëzuar kërkesat pranë Bashkisë Roskovec. Aktualisht janë 9 kërkesa pune të cilat adresohen për punë në fushën e bujqësisë, pastrim gjelbërimit dhe në administratë. Kërkesat për sektorin e bujqësisë dhe të pastrim-gjelbërimit i përkasin arsimit 8/9- vjeçar dhe atij të mesëm, ndërsa kërkesat për punën në administratë i përkasin nivelit të arsimit të lartë. Të punësuar në Bashkinë e Roskovecit janë 178 punonjës dhe vende vakante janë 21.

Ne fushën e Bizneseve pranë Bashkisë Roskovec përkatësisht në sektorin privat të biznesit ushtrojnë aktivitet 481 biznese deri në vitin 2022 dhe 16 biznese të reja të regjistruara në vitin 2023 nga të cilët 2 janë bizneset me të ardhura të larta , Banka Petroleum LTD dhe Alpetrol SH.A. Gjithashtu në këtë zone janë 12 pika grumbullimi



2 fasoneri të cilat janë hapur në vitin 2023, 4 fabrika përpunim drithi, 7 fabrika përpunim ulliri dhe 2 fabrika përpunim qumështi, ndërsa pjesa tjetër e bizneseve janë biznese familjare.

Është e qartë që pavarësisht përpjekjeve proaktive dhe vullnetit të qartë të Bashkisë dhe lidershit të saj për të përmirësuar shërbimet për arsim, punësim dhe gjenerim të ardhurash, sërish sfidat janë të pranishme edhe për shkak të kontekstit të përgjithshëm social dhe ekonomik të zonës dhe Shqipërisë në tërësi. Gjithësesi, projekti nuk mund të adresojë të gjitha nevojat pasi ka një qëllim dhe dy objektiva specifik. Ndaj sugjerimet konkrete janë: zhvillimi i kapaciteteve të stafit të bashkisë për projekte për ngritje fondesh për të ofruar më shumë mundësi për qytetarët si edhe zhvillimi i kapaciteteve të stafit të shërbimeve të bashkisë lidhur me ofrimin e shërbimeve të punësimin, ndërlidhjes me Zyrat e Punës dhe qendrat e formimit profesional si edhe bizneset lokale.

Rekomandohet të përmiresohet lidhja e shkolles me tregun e punës në mënyrë që të ndihmojë në rritjen e punësueshmërisë së të rinjve. Kjo mund të bëhet përmes krijimit të një baze të të dhënave mbi nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës dhe përmes organizimit të takimeve dhe seminareve ndihmuese për të rinjtë që po përgatiten për të hyrë në tregun e punës.

Bashkia Roskovec duhet të vazhdojë të jetë aktive në angazhimin me institucionet vendore dhe kombëtare, si dhe me donatorët dhe partnerët ndërkombëtar, për të siguruar mbështetje financiare dhe teknike në zhvillimin e projekteve të ardhshme. Kjo do të jetë e rëndësishme për të garantuar vazhdueshmërinë e përmirësimeve dhe për të adresuar sfidat e pranishme dhe të ardhshme.

III. Nevojat e komunitetit në Kurjan

Pyetësi për vlerësimin e nevojave në Kurjan dhe bashkia Roskovec janë përgjigjur 106 persona prej të cilëve 88.7% janë nga zona Krujan pjesa tjetër nga Roskveci.




Figura 2: Kampioni i pyetësit

80.9% e të intervistuarve janë meshkuj pjesa tjetër femra. Personat e intervistuar kanë një diapason moshe nga 12 vjeç deri në 70 vjeç. Mosha mestare e të intervistuarve është 46 vjeç, ku pjesa më e madhe e numrit të intervistuarve është 54-67 vjeç dhe 26-37 vjeç. Niveli arsimor i të intervistuarve është 60% me shkollë të mesme dhe 34.5% me fillore, një pjesë shumë e vogël (5.5%) janë me studime universitare ose pas universitare. 70% e të intervistuarve janë pa punë dhe 30% të punësuar. Nga të gjithë të intervistuarit vetëm 6 persona ose 5.5% janë përfitues të shërbimeve që ofron Bashkia për shtresat në nevojë.

Pjesa më e madhe e atyre që janë përgjigjur që janë të punësuar, janë përgjigjur që punojnë në shtet, fermer apo kanë biznes. Nga të intervistuarit, 14 prej tyre janë fermerë, të cilët ushtrojnë aktivitetet e tyre në sektorët e blegtorisë dhe bujqësisë. Ndërkohë, ka interes, edhe pse në numër më të vogël, nga personat që merren me kultivimin e duhanit, grumbullimin e vajit dhe nisjen e bizneseve të reja në fushën e mjeteve bujqësore.




Figura 3: Statusi i punësimit



Nga analiza e pyetjes 2.2 rezulton se 6 nga të intervistuarit operojnë në fushën e biznesit. Saktësisht, dy prej tyre janë aktivë në sektorin e transportit, dy të tjerë menaxhojnë bare ose restorante, ndërsa dy të tjerët janë përgjegjës për një berberi dhe një fabrikë prodhimi vaji.

Kur u pyetën rreth mënyrës së dëshiruar për t'u angazhuar në tregun e punës, personat që kishin përgjigjur “Jo, të papunësuar” shprehën interes të ndryshëm. Rreth 71% e tyre shprehën dëshirën për të punuar si fermerë. Një përqindje më e vogël, 15%, shpreson të punojë si berber ose parukier, ndërsa vetëm 6% shprehu interes për të punuar në sektorin e ndërtimit.

Sa i përket trajnimeve që kanë ndjekur të intervistuarit, vetëm 5.5% e tyre kanë konfirmuar se kanë marrë një formë të trajnimit. Ndërsa pjesa tjetër e përgjigjeve, që përbëjnë shumicën, kanë treguar se nuk kanë marrë trajnime të ndryshme. Fushat ku trajnimet janë marrë variojnë, por dy prej tyre dominojnë: 41% e atyre që kanë marrë trajnime kanë ndjekur trajnime në fushën e estetikës së sallonit të bukurisë, ndërsa 28% kanë marrë trajnime për berber.

Megjithëse numri i atyre që kanë marrë trajnime të tjera është më i vogël, tematikat e trajnimeve janë të larmishme dhe interesante. Disa prej tyre përfshijnë blegtorinë, kultivimin e duhanit si fermer, si dhe marketingun e agroturizmit. Kjo tregon se pavarësisht përqindjes së vogël të individëve që kanë ndjekur trajnime, tematikat e tyre janë shumë të gjera dhe potencialisht me rëndësi për zhvillimin e aftësive në fusha të ndryshme të punës.

Nga 106 të intervistuarit që u pyetën për preferencat e tyre për trajnime të ardhshme që lidhen me punësimin, u zbuluan disa tendenca interesante. Rreth 43% e tyre dëshironin trajnime në specialitetin e fermërisë, duke treguar një interes të madh për aftësi të lidhura me bujqësinë. Ndërkohë, rreth 24% e të intervistuarve dëshironin të merrnin trajnime për berberin dhe paruker.

Pavarësisht përqendrimit të kërkesave në këto dy fusha, u shënua gjithashtu një interes i shumëllojshëm për specialitete të tjera. Këto përfshijnë fushat e vreshtarit, frutikulturës, dhe agrokulturës - të gjitha fusha të lidhura me bujqësinë. Po ashtu, u shfaqën preferenca për specialitete si ndërtimi dhe mekanika, si dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve bujqësore. Kjo gjithëspejtri e interesave tregon se ka hapsira për trajnime më të gjera që mund të përbushin kërkesat e ndryshme të të intervistuarve.




Figura 4: Nevojat për trajnime

Në përgjigje të pyetjes që lejonte më shumë se një zgjedhje, rreth mënyrës se si do të dëshironin të mbështeteshin në rolin e tyre si fermer, të intervistuarit u shprehën me kërkesa të ndryshme. Thuhet se 78% e tyre përmendi mbështetje financiare si një nevojë kyçe, duke treguar nevojën për fonde që do të mundësojnë zhvillimin dhe zgjerimin e aktiviteteve të tyre bujqësore.

Po ashtu, rreth 35% e të intervistuarve dëshironin mbështetje në formën e mjeteve të punës. Kjo mund të përfshijë pajisje, makineri, ose madje edhe burime të tilla si plehra ose farë për të mbështetur prodhimin e tyre. Së fundi, u evidentua një kërkesë për mbështetje në grumbullimin e produkteve. Kjo sugjeron një nevojë për ndihmë në menaxhimin e ciklit të prodhimit, nga kultivimi deri te mbledhja dhe përgatitja e produkteve për tregun.




Figura 5: Format e mbështetjes për biznese



Këto rezultate tregojnë se mbështetja për fermërit duhet të jetë e gjithëpërfshirë, duke i adresuar nevojat e ndryshme të tyre, që variojnë nga financat, mjetet e punës, deri te logjistika e prodhimit.

Bazuar në të dhënat e marrë nga ky pyetësor, implikimet dhe përfundimet mund të përfshijnë disa pikë kyçe. E para, ka një interes të madh për trajnime dhe zhvillim profesional në fushën e bujqësisë dhe fermërisë. Kjo tregon se ka potencial të madh për zhvillimin e këtyre sektorëve në zonat e Kurjan dhe Roskovecit, nëse ofrohen trajnime dhe mbështetje e duhur.

Përgjigjet tregojnë se ndërsa ka një përqindje të lartë të individëve të papunësuar, shumica e tyre dëshirojnë të punojnë, veçanërisht në fushën e bujqësisë dhe fermave. Kjo tregon se ka vullnet dhe gatishmëri për të punuar dhe për të marrë aftësi të reja, por mund të mungojnë mundësitë ose resurset për të arritur këtë.

Në lidhje me këtë, mbështetja financiare dhe ndihma me mjete të punës janë dy nga format më të dëshiruara të mbështetjes për fermërit. Kjo tregon se, përveç nevojës për trajnime dhe aftësi, ka edhe sfida financiare dhe logjistike që duhet të adresohen për të ndihmuar këta individë të bëhen më produktivë dhe të suksesshëm në punët e tyre.

IV. Përfundime

Ky raport paraqet një vlerësim të nevojave dhe sfidave aktuale në fushat e arsimit, punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave në Bashkinë Roskovec. Së dyti, ai prezanton nevojat specifike të grupit të synuar në Kurjan dhe Roskovec. Metodatat e vlerësimit të nevojave në kuadër të këtij projekti kanë përfshirë përdorimin e një pyetësoi online, i cili është plotësuar nga 106 qytetar me asistencën e stafit mbështetës të projektit dhe stafi i Bashkisë në terren në zonat e Kurjanit dhe Roskovecit.

Përveç kësaj, janë organizuar dy grupe fokusi me 11 punonjës të Bashkisë për të diskutuar mbi nevojat e tyre specifike në ofrimin e shërbimeve. Një pyetësor i shkurtër është përdorur gjithashtu për të vlerësuar Bashkinë në lidhje me situatën aktuale të shërbimeve dhe nevojat specifike të tyre.

Përgjigjet e intervistave kanë ofruar një vizion të qartë të sfidave dhe mundësive që ekzistojnë në këto komunitete. Në të njëjtën kohë, ato tregojnë se ka një vullnet të madh për të punuar dhe për të mësuar aftësi të reja, veçanërisht në fushën e bujqësisë. Rezultatet tregojnë se investimet në trajnim dhe mbështetje për këto sektore mund të kenë një ndikim të madh në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punës në këto komunitete.

Këto rezultate mund të ndihmojnë në hartimin e strategjive dhe politikave që adresojnë nevojat e komunitetit në mënyrë efikase dhe efektive. Në këtë mënyrë, ky raport mund të shërbejë si një burim i vlefshëm i informacionit dhe orientimit për të gjithë ata që janë të angazhuar në zhvillimin e këtyre komuniteteve.

Bashkia Roskovec mund të konsiderojë bashkëpunimin me partnerë të tretë, si universitetet, OJF-të dhe kompanitë private, për të ndihmuar në ofrimin e programeve të trajnimit dhe arsimit të përshtatur për tregun e punës lokal. Këto mund të përfshijnë trajnime të specializuara në fusha si bujqësia, teknologjia dhe biznesi.

Në përputhje me tendencën e zvogëlimit të popullsisë së re, Bashkia duhet të ndër marrë hapa për të mbështetur dhe inkurajuar të rinjtë të qëndrojnë në zonë. Kjo mund të përfshijë mbështetjen e sipërmarrjeve të reja, ofrimin e mundësive për zhvillimin profesional dhe stimulimin e kthimit të të rinjve që kanë studiuar jashtë, përmes politikave si marrjen e përparësisë në punësim për ata mbaruar arsimin e



e lartë apo për ata që kanë kryer studime profesionale.

Në përgjithësi, ndërsa sfidat janë të mëdha, potenciali për përmirësim është i madh dhe Bashkia ka tashmë një platformë të mirë për të ndërtuar mbi të. Ky raport është një hapi i rëndësishëm në të kuptuarit e sfidave dhe të gjeturit të mënyrave për t'i përballuar ato. Me angazhim dhe vullnet, Bashkia Roskovec mund të bëjë ndryshime të rëndësishme që do të kenë një ndikim pozitiv në jetën e qytetarëve.

V. Rekomandime

Rekomandime për Bashkinë për shërbimet:

- 1. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore:** Bashkia duhet të krijojë një plan investimesh për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, duke u fokusuar veçanërisht në përmirësimin e laboratorëve shkencorë dhe në furnizimin e mjeteve për mësimdhënie. Kjo mund të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe institucione të tjera të arsimit.
- 2. Shtimi i transportit për nxënësit:** Bashkia duhet të shqyrtojë mundësinë e ofrimit të transportit publik të subvencionuar për nxënësit e shkollave të mesme, duke u përqendruar veçanërisht tek ata që marrin pjesë në programet e trajnimit profesional.
- 3. Rritja e ofertës së kurseve jashtëshkollore:** Bashkia duhet të angazhohet në krijimin dhe zgjerimin e programit të kurseve jashtëshkollore për të rinjtë, duke synuar në zhvillimin e aftësive dhe interesave të tyre.
- 4. Rikthimi i të rinjve:** Bashkia duhet të hartojë strategji për të inkurajuar të rinjtë që kanë mbaruar studimet e tyre jashtë zonës të kthehen në Bashkinë Roskovec. Kjo mund të përfshijë stimulimin e krijimit të vendeve të punës dhe ofrimit të mundësive për zhvillimin profesional.
- 5. Zhvillimi i platformës për informacion mbi punësimin:** Bashkia duhet të ndërtojë një platformë online që do të ndajë informacion mbi mundësitë e punësimit, nevojat e bizneseve për punonjës dhe kualifikimet e tyre.
- 6. Përdorimi më i mirë i pajisjeve të projektit Agrotech:** Bashkia duhet të konsiderojë përdorimin më të mirë të pajisjeve teknologjike dhe mini-robotëve nga projekti Agrotech, duke organizuar trajnime shtesë për nxënësit dhe mësuesit.
- 7. Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave:** Bashkia duhet të investojë në zhvillimin dhe përdorimin e sistemeve më efikase për mbledhjen e të dhënave mbi nevojat e komunitetit. Kjo mund të përfshijë përdorimin e softuerëve për mbledhjen e të dhënave dhe analizën e të dhënave, si dhe trajnimin e stafit për t'i përdorur këto mjete.
- 8. Sinergji mes projekteve të bashkisë:** Bashkia mund të bashkëpunojë me Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për të ndihmuar në menaxhimin dhe vazhdimin e projekteve të ndryshme, përfshirë Agrotech.
- 9. Krijimi i një platforme për lajmërimë pune:** Bashkia mund të bashkëpunojë me bizneset lokale për të krijuar një platformë ku sipërmarrësit mund të postojnë lajmërimë pune dhe nevojat e tyre. Kjo mund të përfshijë trajnime në fushën e

e digjitalizimit për të ndihmuar në krijimin dhe menaxhimin e platformës.

10. Trajnime për personelin e bashkisë: Bashkia duhet të ofrojë trajnime të rregullta për personelin e saj për të rritur aftësitë administrative, komunikuese dhe të ndihmuar në interaktivitetin me vendasit.

11. Rregjistrimi i punëkërkesve dhe kualifikimeve të tyre: Bashkia duhet të ofrojë trajnime për rregjistrimin dhe arkivimin e të dhënave, si dhe promovimin e tyre drejt sektorit privat që ka nevojë për to.

12. Paketa mbështetëse për gjimnazin profesional: Bashkia duhet të bashkëpunojë me gjimnazin profesional për të ofruar ndihmë për nxënësit që janë të interesuar të ndjekin një karrierë profesionale. Kjo mund të përfshijë ndihmë financiare, sesione informuese dhe ndihmë për të gjetur praktika apo pozicione pune pas mbarimit të shkollës.

13. Promovimi i drejtimeve profesionale: Bashkia mund të ndihmojë në nxitjen e të rinjve për të ndjekur karrierë në fushat që janë në nevojë në zonë. Kjo mund të përfshijë bashkëpunim me universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë për të ofruar informacion dhe mundësi për studentët.

14. Krijimi i një programi të karrierës për nxënësit e 9-vjeçarëve dhe gjimnazeve: Bashkia duhet të bashkëpunojë me shkollat, organizatat jofitimprurëse dhe bizneset lokale për të ndihmuar në hartimin e planeve të karrierës për nxënësit. Kjo mund të përfshijë sesione të karrierës, biseda nga ekspertët e fushës dhe mundësi punësimi për të rinjtë.

Rekomandime për Bashkinë për përmbushjen e nevojave të grupit të synuar për veprimtari ekonomike alternative nga kultivimi i kanabis:

- 1. Zhvillimi i trajnimeve në fushat e caktuara të veprimtarisë të grumbullimit:** Bashkia duhet të përqendrohet në zhvillimin e trajnimeve për bizneset e grumbullimit në fushat si menaxhimi, financat, infrastruktura, mirëmbajtja dhe promovimi. Trajnime të tilla do të ndihmojnë bizneset lokale të rrisin efikasitetin dhe produktivitetin e tyre.
- 2. Shtimi i trajnimeve në blegtori dhe bujqësi:** Bashkia duhet të synojë të rrisë ofertën e trajnimeve në fushat e blegtorisë dhe bujqësisë, veçanërisht në agrokulturë (frutikulturë, vreshtari, ullishte, kultivim duhani) dhe prodhimin e perimeve.
- 3. Ndihmë financiare dhe mjete pune për fermat:** Bashkia duhet të hartojë strategji për të ofruar më shumë ndihmë financiare dhe mjete pune për fermat, në mënyrë që të inkurajojnë rritjen dhe zhvillimin e bizneseve lokale të blegtorisë dhe bujqësisë.



4.Zhvillimi i trajnimeve në fushat e shërbimeve: Bashkia duhet të krijojë trajnime në fushat e shërbimeve si HORECA (hoteli, restorante, kafene), mekanikë e mjeteve të punës në fushën e blegtorisë dhe bujqësisë, si dhe trajnime të specializuara në ndërtim (elektracist, hidraulik, murator).

5.Përfshirja e më shumë vajzave dhe grave në trajnime: Meqenëse 81% e të intervistuarve janë meshkuj, Bashkia duhet të hartojë strategji për të inkurajuar pjesëmarrjen e më shumë grave në trajnime. Kjo mund të përfshijë ofrimin e trajnimeve specifike për gratë dhe stimulimin e tyre për të marrë pjesë në fushat ku kanë qenë tradicionalisht të përfaqësuara në mënyrë të pabarabartë.

Në të gjitha këto veprime, Bashkia duhet të punojë në bashkëpunim me partnerët e saj në komunitet, duke përfshirë shkollat, universitetet, organizatat jofitimprurëse dhe bizneset lokale. Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar dhe të përqendruar mund të arrihet një ndryshim i madh në ofrimin e shërbimeve për nxënësit e 9-vjeçareve dhe gjimnazeve në Bashkinë Roskovec.

VI. Anekse

Më poshtë gjenden për referencë pyetësorët e ndërtuar për të hartëzuar dhe vlerësuar nevojat e Bashkisë së Roskovecit për situatën aktuale të shërbimeve të edukimit, punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave si edhe për vlerësimin e nevojave të grupit të synuar në Kurjan dhe në tërësi në Bashkinë Roskovec.

6.1 Guida e intervistës për punonjësit e bashkisë

I. Pyetje për shërbimet e edukimit:

- Cilat janë shkollat e disponueshme në Bashkinë Roskovec?
- Cilat janë nivelet arsimore që ofrohen në këto shkolla?
- Sa e rëndësishme konsideroni cilësinë e shërbimeve arsimore të ofruara nga Bashkia Roskovec?
- Cilat janë sfidat kryesore që Bashkia has në ofrimin e këtyre shërbimeve?
- Cilat janë sfidat kryesore që shkollat përballen në Bashkinë Roskovec?

II. Pyetje për shërbimet e punësimit:

- Cilat janë shërbimet e punësimit që ofrohen nga Bashkia Roskovec?
- Sa e lehtë është për të rinjtë dhe grupet e skajuar të gjejnë një punë në Bashkinë Roskovec?
- Cilat janë sfidat kryesore në zbatimin e shërbimeve të punësimit në Bashkinë Roskovec?

III. Pyetje për shërbimet e gjenerimit të të ardhurave:

- Cilat janë shërbimet për gjenerimin e të ardhurave që ofrohen nga Bashkia Roskovec?
- A keni informacion për mundësitë e bizneseve të vogla dhe të mesme në Bashkinë Roskovec?
- Cilat janë sfidat kryesore që bizneset përballen në Bashkinë Roskovec?

6.2 Udhëzues për fokus grup me Bashkinë

Projekti: "Rivitalizimi i Shkolla Qendër Komunitare në Kurjan për një qasje më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e skajuar"

Projekti zbatohet nga Bashkia e Roskovecit në partneritet me SCiDEV dhe bashkëfinansuar nga Bashkimi Europian

Udhëzuesi për pyetjet për vlerësimin e situatës aktuale të shërbimeve të edukimit, punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave në Bashkinë Roskovec

Ky udhëzues përmban një seri pyetjesh për të vlerësuar situatën aktuale të shërbimeve të edukimit, punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave në Bashkinë Roskovec nga vetë bashkia. Pyetjet janë ndarë në kategori të ndryshme dhe kanë për qëllim të mbledhin informacionin e nevojshëm për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve aktuale dhe për të identifikuar potencialet për përmirësim.

I. Pyetje për shërbimet e edukimit:

- Cilat janë shkollat e disponueshme në Bashkinë Roskovec?
- Cilat janë nivelet arsimore që ofrohen në këto shkolla?
- Sa e rëndësishme konsideroni cilësinë e shërbimeve arsimore të ofruara nga Bashkia Roskovec?
- Cilat janë sfidat kryesore që Bashkia has në ofrimin e këtyre shërbimeve?
- Cilat janë sfidat kryesore që shkollat përballen në Bashkinë Roskovec?

II. Pyetje për shërbimet e punësimit:

- Cilat janë shërbimet e punësimit që ofrohen nga Bashkia Roskovec?
- Sa e lehtë është për të rinjtë dhe grupet e skajuar të gjejnë një punë në Bashkinë Roskovec?
- Cilat janë sfidat kryesore në zbatimin e shërbimeve të punësimit në Bashkinë Roskovec?

III. Pyetje për shërbimet e gjenerimit të të ardhurave:

- Cilat janë shërbimet për gjenerimin e të ardhurave që ofrohen nga Bashkia Roskovec?
- A keni informacion për mundësitë e bizneseve të vogla dhe të mesme në Bashkinë Roskovec?
- Cilat janë sfidat kryesore që bizneset përballen në Bashkinë Roskovec?



6.3 Pyetësi për qytetarët

Projekti: "Rivitalizimi i Shkolla Qendër Komunitare në Kurjan për një qasje më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e skajuar"

Projekti zbatohet nga Bashkia e Roskovecit në partneritet me SCiDEV dhe bashkëfinansuar nga Bashkimi Europian

Udhëzuesi për pyetjet për vlerësimin e situatës aktuale të shërbimeve të edukimit, punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave në Bashkinë Roskovec

PYETËSOR PËR HARTËZIMIN DHE VLERËSIMIN I NEVOJAVE TË GRUPIT TË SYNUAR NË KRUIAN, BASHKIA ROSKOVEC

QELLIMI: Ky pyetësor do të shërbejë për hartëzimin dhe vlerësimin e nevojave të grupit të synuar. Do të vlerësohen nevojat specifike të grupit të synuar dhe do të identifikohen qartë nevojat e tyre për kualifikim, trajnim profesional, punësim dhe gjenerim të të ardhurave.

SEKSIONI I – INFORMACION PËR TË INTERVISTUARIN

Njësia Vendore	
Fshati	
Emeri Mbiemri	
Mosha e të intervistuarit	
Gjinia	
Niveli i Arsimimit	
Kontakt	

SEKSIONI II – INFORMACION I PËRGJITHSHËM

2.1 A jeni i punësuar?

PO JO



Nëse PO, specifiko:

Biznes: PO JO

Administratë: PO JO

Fermer: PO JO

Tjetër _____

Nese Biznes specifiko:

Nese JO specifiko nevojën per te hyre ne tregun e punes: _____

SEKSIONI III – NEVOJAT TRAJNIME DHE RRIJJE TË KAPACITETEVE

3.1 A keni marrë ndonjë trajnim që nxit punësimin tuaj?

PO JO

Nëse PO, në cilat fusha? Ju lutem specifikoni:

- Parukeri/berber
- Estetike, sallon bukurie
- Marketingu i agroturizmit
- Asistent zyre
- Marketing digjital
- Ndonjë tjetër _____



3.2 Ku mendoni ju se keni më shumë nevojë për trajnim në lidhje me punësimin?

- Parukeri/berber
- Estetike, sallon bukurie
- Marketing i agroturizmit
- Asistent zyre
- Marketing digjital
- Ndonjë tjetër

3.3 Nëse dikush do tju mbështeste si fermer , ku e kërkoni këtë?

- Mbështetje me trajnime
- Mbështetje për mbjelle
- Mbështetje për grumbullim
- Mbështetje me mjete pune
- Mbështetje për çertifikimin
- Ndonjë tjetër _____

3.4 Nëse dikush do tju mbështeste për një start up të ri , ku e kërkoni këtë?

- Mbështetje me trajnime
- Mbështetje financiare

3.5 A jani përfitues nga shërbimet që ofron Bashkia për shtresat në nevojë ?

PO

JO

Nëse PO, Ju lutem specifikoni :

- _____

6.3 Lista e pjesëmarrësve në fokus grupe

Projekti: "Rivitalizimi i Shkolla Qendër Komunitare në Kurjan për një qasje më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e skajuar"

Gjatë 2 fokus grupeve në datë 24 Prill 2023 morën pjesë grupi i punës të projekti dhe ekspertët e bashkisë për arsimin, bujqësinë dhe biznesin.


Grupi i Punës së projektit:

1. Qamil Kuka Drejtues Grupi Projektit
2. Qamil Xhoka- Asistent Projektit
3. Aleksander Goga- Financier Projektit
4. Aleksander Sheme – Komuniteti Rom, Mesues
5. Durim Bakaj – Punet Sociale
6. Behar Shytia- Specialist bujqesie
7. Zare Shabanaj - Pergjegjese e njesise te integrimit dhe Mbikqyrese e Projektit
8. Ervisa Baxhia - Kryeinspektore e Arsimit
9. Anxhela Ruko - Pergjegjese e Sektorit te Biznesit
10. Graciela Brako - Supervizore per menaxhimin e Burimeve Njerezore
11. Viktor Kola - pergjegjes i sektorit te Ujitjes dhe Kullimit

Fokus grupi u organizua në tre tema kryesore pyetje për shërbimet e edukimit , pyetje për shërbimet e punësimit dhe pyetje për shërbimet e gjenerimit të të ardhurave.

6.4 Fotografi nga aktivitetet për realizimin e vlerësimit të nevojave

Takimet 24 Prill 2023 (fokus grupe) dhe trajnimi për realizimin e pyetësorëve në terren



Takime Shkolla Kurjan



